



**PERSONI I AUTORIZUAR NR. 224**

**Instituti për testim dhe certifikim sh.a., Bul. T. Bati 299, Louky, Zlin 763 02  
Republika Çeke**

*Vendimi për autorizim nr. 2/2014 lëshuar me datën 10. Mars 2014*

**CERTIFIKATE E PRODUKTIT  
Nr. 14 0553 V/AO**

Në përputhje me dispozitat e nenit 5a të Urdhëresës Administrative nr. 163/2002, në bazë të cilës përcaktohen kërkesat për disa produkte ndërtimore si dhe bazuar në Urdhëresën Administrative nr. 312/2005. Personi i autorizuar nr. 224 vërteton se produkti ndërtimor:

**Pileta (ujëmbledhës) për shkarkimin e ujrave të kanalizimit dhe të dyshemesë**

të cilat plasohen në treg nga prodhuesi

**Miroslav Chuděj s. r. o.**  
**756 62 Hutisko-Solanec 310, Republika Çeke**  
**Numri fiskal: CZ25390236**

Vendi i prodhimit:

**Miroslav Chuděj s. r. o.**  
**756 62 Hutisko-Solanec 310, Republika Çeke**

Janë hulumtuar të dhënat e paraqitura nga prodhuesi, janë realizuar testimet e produktit mostër dhe është vlerësuar sistemi i prodhimit si dhe është konkluduar që produkti i plotëson kërkesat themelore të përcaktuara me Urdhëresë Administrative, të konkretizuara në Certifikatën teknike ndërtimore nr. **STO – AO 224 – 674/2014**.

Personi i autorizuar nr. 224 ka konstatuar se sistemi i prodhimit është në përputhje me dokumentacionin teknik dhe siguron që produktet të cilat plasohen në treg të plotësojnë kërkesat e përcaktuara më lart sipas Certifikatës teknike ndërtimore dhe janë në përputhje me dokumentacionin teknik sipas nenit 4, paragrafi 3.

Certifikata lëshohet në bazë të protokollit përfundimtar nr. **783501829/2014** të datës 24.9.2014, i cili përmbanë konkluzionet e hulumtimit dhe vërtetimit, rezultatet e testeve dhe përshkrimin e përgjithshëm të produktit të nevojshëm për identifikim.

Kjo certifikatë mbetet e vlefshme deri në ndryshimin e kërkesave bazuar në udhëzimet teknike ose bazuar në certifikatën teknike ndërtimore sipas të cilave është lëshuar kjo certifikatë, apo ndryshimin e kushteve të prodhimit në vendin e prodhimit ose sistemit të prodhimit.

Personi i autorizuar nr. 224 do të mbikqyrë së paku një herë në 12 muaj funksionimin e rregullt të prodhimit në vendin e prodhimit, bazuar në nenin 5a të urdhëresës administrative të cekur më lartë. Në rast se personi i autorizuar nr. 224 identifikon mangësi, atëherë ai/ajo është i/e autorizuar të anuloj ose të ndryshoj këtë certifikatë.

**Lëshuar në Zlin me 24.9.2014**



Nënshkrimi

**Dr. Radomir Covelik (doktor i shkencave natyrore)**  
**Përfaqësues i personit të autorizuar nr. 224**